REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I MINISTRAVE
# KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

## VENDIM

Nr.12, datë 03.10.2018

## PËR

## MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT DOBRENJ-TOMORRICË, NË PËRROIN E HIJES", BASHKIA GRAMSH DHE BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë koncesionare "Daab Energy Group" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

## VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i Hidrocentralit Dobrenj-Tomorricë, në përroin e Hijes", Bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare "Daab Energy Group" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkive Gramsh dhe Skrapar.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**